



Më
 Data

28-12-2018

[Signature]

REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
 GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:042127
 Datë: 27.11.2018
 Numri i dokumentit: 00178055

P.nr.1957/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal - në përbërje nga gjyqtari i vetëm gjykuese Hysnije Gashi si dhe me zyrtaren ligjore Albana Ujupi, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] me vendbanim në fshatin [REDACTED], Komuna Ferizaj për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1704-5/2016 të datës 08 gushte 2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit, Avdullah Abedini, të pandehurit [REDACTED], me datë 20.11.2018 mori dhe publikisht komunikoi, ndërsa me datë 20.11.2018 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

[REDACTED] me vendbanim në Ferizaj rr. [REDACTED], i lindur me dt. [REDACTED], në fshatin [REDACTED], Komuna Ferizaj, nga i ati [REDACTED] e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] ka te kryer shkollën mesme, me numër personal te letërnjoftimit [REDACTED] punon si asistent administrativ ne Kuvendin Komunale të Komunës së Ferizajt, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse

Me datë 21.08.2016, rreth orës 14:30, në fshatin Balaj, Komuna Ferizaj, saktësisht në pishinë "Ujvara" i pandehuri ka sulmuar fizikisht të dëmtuarin [REDAKTUAR], e që ka ardhur si rezultat i një mosmarrëveshje aty për aty ku pas i qe fëmija i të dëmtuarit kishte lozur me top në pishinë dhe se i dëmtuari ia kishte tërhequr vërejtjen disa herë ku me pas shkon që t'ia merr topin, ku ndërhyr babi i të dëmtuarit [REDAKTUAR] ndërsa i pandehuri e godet dy apo tre here me grushte,-

Me të cilën ka kryer veprën penale sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së.

Andaj në bazë të dispozitës ligjore të sipër theksuar, si dhe dispozitave ligjore nga neni 4,8,17,21,28, 41,42,43,45,46,73,74,75 të KPK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehur in e

GJYKON

DËNIM ME GJOBË në lartësi prej 200€ /dyqind euro/ të cilin gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do të shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës të paguaj shumën prej 50€ /pesëdhjete euro/, në afat prej 15 ditëve, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit obligohet ta paguaj shumën prej 30€ (tridhjete/euro), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzat PP/II.nr.1704-5/2016 të datës 08 gushte 2017, ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR] me vendbanim në fshatin [REDAKTUAR], Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 par. 1 të KPRK-së, mbeti në tërësi pranë aktit akuzues, duke kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari i vetëm

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësorë me datë 20.11.2018, në të cilën shqyrtim gjyqësor: *i akuzuari është deklaruar fajtor për veprën për të cilën me ngarkon akuzat, duke shprehur pendimin e thellë veprë penale të kryer, i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë si dhe pasojat që mund të vinë nga ky pranim me vetëdije dhe në shenjë pendimi pranoj veprën penale, i premtoj gjykatës se me nuk do të kryej veprë penale, andaj i kërkoj gjykatës të më shqipton një dënim sa të butë.*

Prokurori i Shtetit Avdullah Abedini duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësorë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 KPPK-së, edhe pas udhëzimit në kuptim të nenit 323 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarit në

shqyrtimin gjyqësorë dhe atë: aktespertime i datës 20.07.2017 e punuar nga , deklarata e te dëmtuarit të dhënë në polici e datës 31.08.2016, si dhe fotografit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore;

- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të kësaj aktakuze.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së .

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se në shqyrtimin gjyqësorë ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, nuk është vërtetuar se ka qenë i dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese, gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], Komuna Ferizaj për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që ne emër të shpenzimeve të procedurës të paguaj shumën prej 20€ /njëzet/ euro, në afat prej 15 ditëve, nga dita kur aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë.

Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit obligohet ta paguaj shumën prej 30€(tridhjetë/euro), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.1957/17, Më dt.26.11.2018

Zyrtare ligjore,
Albana Ujupi

Gjyqtari,
Hysnije Gashi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet Gjykatës Themelore Ferizaj